



STATUTI
I
SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
“FRIENDS CAFE” SH.P.K

NENI 1
EMRI

Sot me date 24.06.2019 Shoqeria tregtare private me përgjegjesi të kufizuar emërtohet “FRIENDS CAFE” SH.P.K, e cila ketu e me poshte do te quhet shoqëria. Ajo krijohet nga ortakët themelues: **Z. Florenc Gjyla, i biri i Sami-ut, lindur me 04.08.1989 ne Lene, Mat dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit/pasaporte me numer BR8243322 dhe numer personal: I90804072L**, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe **Z. Eno Alikaj, i biri i Agron-it, lindur me 01.10.1986 ne Tirane dhe banues ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit/karte identiteti me numer 031759418 dhe numer personal: I61001073C**, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

NENI 2
FORMA

Forma ligjore: **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar.**

NENI 3
BAZA JURIDIKE

Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin ne përputhje me kete legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Biznesit.

NENI 4
SELIA

Selia e shoqerise do te jete ne adresen: Tirane, « Rruga e Duresit », Godina 85, Hyrja 1, me numer pasurie 4/7+1-2, volumi 4, faqe 164, Zona Kadastrale 8210 dhe mund te ndryshoje adresen e selise se saj vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 5
TERRITORI

Shoqëria e zhvillon aktivitetin ne territorin e Republikes se Shqipërisë.

Shoqeria mund te krijojë dege (filiale) ose perfaqesi, ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera, ne përputhje me legjislacionin e vendeve perkatese.

NENI 6
OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

- **Bar Kafe Etj...**

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqëria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organet kompetente.

NENI 7
KOHEZGJATJA

Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e saj per nje periudhe te pacaktuar kohore, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit, me perjashtim te rastit te mbarimit te saj sipas kushteve te parashikuara me ligj ose me vendim te Asamblese se Ortakeve.

AUTORITETI I ORTAKEVE, LIBRI I SHOQERISE, KONFIDENCIALITETI

NENI 8
FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit te ortakut /eve dhe perqindja e fitimeve ose e humbjeve do te kene si kriter baze kapitalin e Shoqerise si dhe kompetencat qe gezojne ortaket ne marrjen e vendimeve te cdo karakteri, te percaktuara ne kete statut.

NENI 9
LIBRI I SHOQERISE

Per te saktësuar veprimtarine e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punes shoqeria do te çele librin e vet i cili do te quhet Libri i Shoqerise.

NENI 10
KONFIDENCIALITETI

Ortakut/et ose Asambleja e Ortakeve si dhe personat e tjere te pranuar prej tij/tyre ne Shoqeri bien dakord qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe disponon shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe, cdo lloj materiali, si dhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.

NENI 11
DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxirren nga Shoqeria dhe jane te destinuara per te tretet, si letrat, faturat, lajmerimet, publikimet e ndryshme etj, duhet te tregojne lexueshem emrin e Shoqerise dhe pas tij fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar", ose iniciallet "SH.P.K.", si dhe emrin e administratorit.

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET,
PJESET DHE TRANSFERIMI I TYRE

NENI 12
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100 leke (nje qind). Ky kapital eshte teresisht i nenshkruar dhe i shlyer nga te dy ortaket ne mase te barabarte, secili ka shlyer 50% te vleres se kapitalit. Shoqeria mund te shtoje ose te zvogeloje kapitalin, ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj, sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

NENI 13
KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i Ortakutve te Shoqerise Z. Florenc Gjyla dhe Z. Eno Alikaj, secili me pjesemarrje ne masen 50% (pesedhjete perqind) ne vleren prej 50 leke (pesedhjete leke), ne total vlere e kapitait themeltar eshte 100 leke.

NENI 14
PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte i perbere prej 2(dy) kuotash, plotesisht te shlyera, secila kuote eshte me vlere nominale 50 leke (pesedhjete leke).

NENI 15
LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete, ne qofte se Asambleja e ortakeve vendos per kete. Ai mund te lihet peng sipas legjislacionit ne fuqi.

Gjithashtu kapitali themeltar eshte i transferueshem ne rruge trashëgimie ku bashkeshortja/i, paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, me vendim te asamblese se ortakeve dhe sipas kushteve qe lejohen me ligj.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

NENI 16
ASAMBLEJA E ORTAKEVE



Aasambleja e Ortakeve eshte organi me i larte drejtues dhe ushtron te gjitha kompetencat qe i njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

NENI 17
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe perpilon, miraton rregulloret per Shoqerine apo sektore te vecante te veprimtarise.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit dhe transferimin e pjeseve te kapitalit.
- Vendos per politiken afariste te Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabel.
- Shqyrton bilancin vjetor, percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos per marrjen e kredive.
- Vendos per krijimin e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si dhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizike apo juridike.
- Vendos per marrredheniet me te rendesishme ekonomike dhe financiare te Shoqerise me persona te tjere fizike apo juridike, vendas apo te huaj.
- Vendos per mbarimin e Shoqerise, likujdimin e saj si dhe per shnderrimin e Shoqerise nga shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera ligjore.
- Vendos per cmimin e mallrave/sherbimeve.
- Vendos per pagat e punonjesve ne Shoqeri.

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 18
ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJ

Ortaket kane vendosur qe shoqeria do te kete nje administrator te emeruar nga Asambleja e ortakeve. Kompetencat e administratorit, ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e tij te emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, administratori ka edhe keto kompetenca:

- Realizoj administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e Shoqerise ne marrredheniet me persona te tjere juridike apo fizike.
- Kujdeset per funksionimin e perditeshem normal te Shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit.
- Pergatite dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqet Ortak-ut/eve per shqyrtim.
- Koordinoje veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.
- Shqyrtoje ofertat dhe pergatit kerkesat te cilat ua paraqet Ortak-ut/eve per miratim.
- Ndjeke problemet e Shoqerise ne marrredhenie me organet shteterore ose caktoje ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.
- I propozon Ortakut te Vetem/Ortakeve te Shoqerise cmimet e mallrave/sherbimeve, si dhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.
- I propozon Ortakut te Vetem/Ortakeve rregulloret per sektoret e vecante te Shoqerise.
- Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve qofte per shkelje ligjore, qofte per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.
- Kompetencat e Administratorit jane te pakufizuara.

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, DIVIDENTET

NENI 19
LIBRAT E SHOQERISE



Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec Librit te Shoqerise, ne te cilin shenohet emri i plote i ortakut te vetem/ortakeve, kapitali themeltar, si dhe vendimet e ortakeve, dokumentacionin kontabel dhe libra te tjere.

**NENI 20
BILANCI**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel miratohen nga asambleja e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

**NENI 21
DIVIDENTET**

Ortaku i vetem/asambleja e ortakeve miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Percakton fitimin e vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per: rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete ortaku/asambleja e ortakeve, fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjetere i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme, keshtu ortaku i vetem/asambleja e ortakeve percakton dhe dividentin.

MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

**NENI 22
MBARIMI**

Shoqeria mbaron me vendim te asamblese se ortakeve ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara ne ligj.

**NENI 23
LIKUIDIMI**

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi asambleja e ortakeve cakton nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit. Mbas pagimit te kreditoreve asambleja e ortakeve mban pjesen e mbetur te kapitalit.

MOSMARREVESHJET DHE DISPOZITAT E FUNDIT


**NENI 24
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se Shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit do t'i paraqiten per zgjidhje Gjykates Kompetente Shqiptare.

**NENI 25
DISPOZITA E FUNDIT**

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet ne ndonje Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashte Shqiperise. Shoqeria do te kete vulen e saj, forma dhe madhesia e se ciles do te percaktohen nga ortaku i vetem/ ortaket. Administratori i Shoqerise eshte Z. Florenc Gjyla dhe do te qendroje ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare. Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater)kopje, duke patur secila fuqi te njejte ligjore.

ORTAKET E SHOQERISE


Emer, Mbiemer, Firme


Emer, Mbiemer, Firme



VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, ne Tirane, me date 24.06.2019 (dymije e nentembehjete), ne Dhomen e Noterise Tirane; para meje noteres se kesaj dhome te quajtures Arta Gj. Pjeternikaj, me seli ne Blv. " Zogu I", Rr. "Dervish Hatixhe", Tirane, u paraqiten personalisht shtetasit:

- *Z. Florenc Gjyla, i biri i Sami-ut, lindur me 04.08.1989 ne Lene, Mat dhe banues ne Tirane, identifikuar prej meje noteres nga leternjoftimi/pasaporte me numer BR8243322 dhe numer personal: I90804072L, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, dhe*
 - *Z. Eno Alikaj, i biri i Agron-it, lindur me 01.10.1986 ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar prej meje noteres nga leternjoftimi /karte identiteti me numer 031759418 dhe numer personal: I61001073C, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,*
- ne cilesine e perfaqesuesve ligjore te "FRIENDS CAFE" sh.p.k themelim e siper.

Te paraqiturit jane persona madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, gje per te cilen u sigurova sipas ligjit, te cilet ne baze te Ligjit 110 dt. 20.12.2018 "Per Noterine", i ndryshuar, kerkuan legalizimin e aktit bashkangjitur "Statutit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "FRIENDS CAFE" sh.p.k perpiluar prej kesaj zyre noteriale duke deklaruar se jane plotesisht dakort me permbajtjen e dokumentit bashkangjitur dhe e nenshkruan ate pa verejtje perpara meje noteres.

Duke qene se ky akt eshte shprehje e lire e vullnetit te te paraqiturve dhe pasi u sigurova se u nenshkrua rregullisht ne pranine time, une Noterja vertetoj nenshkrimin e tyre ne perputhje me Ligjin per Noterine.

NOTERE
ARTA GJ. PJETERNIKAJ